



22278 Prot

BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK
GRUPI I KËSHILLTARËVE TË PARTISË DEMOKRATIKE

Tiranë, me 23.12.2015

Drejtuar: Z. Erion Veliaj
Kryetar
BASHKIA TIRANË

Për dijeni: Z. Aldrin Dalipi
Kryetar
Këshilli Bashkiak

Lënda: Kërkesë për dhënie informacioni

I nderuar Z. Kryetar,

Në mbështetje të nenit 29, pika 3, të ligjit nr. 8652, date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, nenit 11, pika 4 të Rregullores se funksionimit të Këshillit Bashkiak, nenit 14, pika 1, shkronja “c”i “Rregullores per organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë se Tiranës”, ne cilesine dhe në ushtrim të funksionit të Kryetarit të Grupit të Këshilltarëve të Partisë Demokratike, kërkoj të pajisem me informacionin e detajuar si dhe dokumentacionin përkatës, në lidhje **me shndërrimin e sheshit “Nënë Tereza” në pedonale** dhe ushtrimin aty të aktivitetit tregtar nga subjektet private, konkretisht:

1. Cila është procedura e ndjekur për zbatimin e nismës së shndërrimit të përkohshëm të sheshit "Nënë Tereza" në pedonale, baza ligjore mbi të cilën është mbështetur kjo procedurë si dhe akti administrativ përkatës (*dokumentacioni përkatës*);
2. Çfarë ndërhyrjesh funksionale janë kryer paraprakisht me qëllim shndërrimin e përkohshëm të sheshit të sipërpermendur në pedonale (dekorime/vendosje objektësh të lëvizshëm, etj.) (*dokumentacioni përkatës*);
3. Cila është vlera e tyre dhe cili subjekt ka përballuar shpenzimet e nevojshme për realizimin e sa më sipër? (*dokumentacioni përkatës*);
4. Nëse shpenzimet e përmendura në pikën 3, janë përballuar nga subjekte private, cila është marrëdhënia juridike (kontratë/marrëveshje/etj.) me Bashkinë e Tiranës, që rregullon këto shpenzime? (*dokumentacioni përkatës*);
5. Cila është marrëdhënia juridike e krijuar ndërmjet Bashkisë së Tiranës dhe subjekteve private, të cilët ushtrojnë veprimtari tregtare të përkohshme në këtë shesh, duke filluar nga data 6 dhjetor 2015 (kontratë qiraje/dhënie në përdorim/etj.)? (*dokumentacioni përkatës*);
6. Cilat janë të drejtat dhe detyrimet (financiare dhe jo-financiare) të Bashkisë së Tiranës dhe subjekteve private që rrjedhin nga marrëdhënia juridike ndërmjet tyre; (*dokumentacioni përkatës*)

Duke e vlerësuar si thelbësore për respektimin e standardeve të shtetit të së drejtës jo vetëm garantimin e parimit të ligjshmërisë, por edhe qeverisjen transparente, mbetemi në pritje të informacionit dhe dokumentacionit përkatës, brenda afatit ligjor.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

LEONARD OLLI

KRYETAR

GRUPI KËSHILLTARËVE TË PARTISË DEMOKRATIKE

PER T'U PLOTESUAR PER OBJEKTET E KERKUARA									
Nr.	Objekti	Fondi limit/Vlera e financimit (pa T.V.SH)	Burimi i financimit	Vlera e kontratës	Periudha e parashikuar e realizimit	Procedura e perdorur (prokurim/donacion, etj.)	Data dhe nr. i kontratës	Operatori/bashkimi i operatorëve ekonomikë fitues i kontraktuar	Dokumenta bashkelidhur/nr.fq